



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:033019

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05811378

KA.nr.423/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Pozhegu Brothers” SH.P.K, kundër të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) Prishtinë dhe Komuna e Prishtinës, me kërkesëpadi për shkak të heshtjes administrative dhe anulimin e vendimit të shkallës së parë me Nr.A-176/14 të datës 09.10.2014, pas mbajtjes se seancës me datë 22.05.2024, konform nenit 34 të LKA-së, më datë 22.05.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PEZULLOHET procedura e shqyrtimit gjyqësor në këtë konflikt administrativ, sepse është nxjerrë akti administrativ i propozuar nga paditësi.
- II. Secila pale i barta shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Me datë 03.03.2020 paditësi “Pozhegu Brothers” SH.P.K, ka parashtruar padi kundër të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) Prishtinë dhe Komuna e Prishtinës, me kërkesëpadi për për shkak të heshtjes administrative dhe anulimin e vendimit të shkallës së parë me Nr.A-176/14 të datës 09.10.2014.

Me datë 22.05.2024 gjykata mbajti seancë publike të shqyrtimit kryesor, me pjesëmarrje të përfaqësuese e autorizuar të paditësit me autorizim të datës 09.11.2022 Gerta Ragipi avokate, përfaqësuesit të paditues Komuna e Prishtinës D.Gj. me autorizim Nr.392/2024, në mungesë të përfaqësuesit të paditurës MMPH, të cilët ftesën për seancë e kanë pranuar në mënyrë të rregullt ndërsa janë deklaruar me parashtrësë për seancë.

Në fjalën hyrëse përfaqësuesja e paditësit e njoftoj gjykatën se kanë pranuar prova të reja dhe Komuna e Prishtinës ka nxjerrë vendim për leje të legalizimit për përfundim të ndërtimit, për objektin afarist banesor C-11 e që është i njëjti objekt ndërtimi për të cilën është parashtruar padia dhe i propozoj gjykatës që të merr vendim sipas ligjit. Përfaqësuesi i te paditurës nuk e kundërshtoj propozimi.

Gjykata vlerësoj se baza e kërkesëpadisë është heshtje administrative në këtë rast, me kërkesë për lëshimin e lejes ndërtimore nga ana e paditësit, për objektin nr.C-11/A1 lokali nr.3 me adresë në Prishtinë Mati 1, Rr.Muharrem Fejza, për çka e paditura e dytë ka marrë vendim për leje të legalizimit për leje të ndërtimit prandaj konstatoj që kërkesëpadija ka mbetur pa objekt të shqyrtimit prandaj konform nenit 34 të LKA-së mori vendim për pezullim të procedurës. Vendimi për shpenzime procedurave u mor në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.423/22, datë 22.05.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.

